



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA DIBËR
DREJTORIA PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TERRITORIT

PROJEKT-VENDIM

Nr. 01 Datë 31/03/2026

“Për Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Dibër me objekt “Rigjenerimi Urban në zona periferike dhe informale dhe në fshatra me popullsi të dendur, etj Rajonet 1&2 - Rigjenerim urban i fshatit Lurë, Bashkia Dibër””

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimit Këshillit Bashkiak nr.101 datë 29.12.2025 “Për buxhetin vjetor vitit 2026”, i konfirmuar nga ana e institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër me shkresën nr.1212/1 prot. datë 06.01.2026:

Kërkojmë:

- I. Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Dibër me objekt “Rigjenerimi Urban në zona periferike dhe informale dhe në fshatra me popullsi të dendur, etj Rajonet 1&2 - Rigjenerim urban i fshatit Lurë, Bashkia Dibër”;
- II. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Urbanistikës, Drejtoria Juridike pranë Bashkisë Dibër.
- III. Ky vendim hyn në fuqi pa miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

PËR BASHKINË DIBËR:

Drejtor Juridik

Drejtorja Planifikimit dhe Zhvillimit Territorit

Ismet Saraçi

Blerina Manreka

KRYETARI I BASHKISË
Rahim Spahiu

Në mungesë dhe me porosi

Zëv. Kryetar
Lorenc Cibaku

MARRËVESHJE INVESTIMI

ndërmjet

Fondit Shqiptar të Zhvillimit

dhe

Bashkisë Dibër

për

Objektin:

**“Rigjenerimi Urban në zona periferike dhe informale dhe në fshatra me popullsi të dendur, etj
Rajonet 1&2 - Rigjenerim urban i fshatit Lurë, Bashkia Dibër”**

TIRANË 25.03.2026

Tabela e Pëmbajtjes

Marrëveshje Investimi	3
Objekti i Marrëveshjes	3
Detyrimet e NJVV	3
Detyrimet e FSHZH	4
Realizimi i punimeve	5
Dorëzimi i objektit	5
Zgjidhja e Marrëveshjes para afatit të përfundimit të saj	6
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve	7
Komunikimi	7
Hyrja në fuqi	7

MARRËVESHJE INVESTIMI

Kjo Marrëveshje Investimi (MI), lidhet sot me datë 25.03.2026 ndërmjet:

Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), përfaqësuar nga Z. Dritan Agolli, Drejtor Ekzekutiv,

dhe

Bashkisë Dibër (NjVV), përfaqësuar nga Z. Rahim Spahiu, Kryetar i Bashkisë.

Neni 1

Objekti i Marrëveshjes

- 1.1 Objekti i kësaj Marrëveshje është financimi i punimeve për realizimin e objektit: "Rigjenerimi Urban në zona periferike dhe informale dhe në fshatra me popullsi të dendur, etj Rajonet 1&2 - Rigjenerim urban i fshatit Lurë, Bashkia Dibër", si dhe përcaktimi i detyrimeve të NJVV-së:
 - (i) për lëshimin e lejes së ndërtimit;
 - (ii) për sigurimin e lejeve të tjera administrative të nevojshme për realizimin e projektit;
 - (iii) për përfundimin e çdo procedure shpronësimi për interes publik duke siguruar financimin e plotë të kosteve përkatëse të shpronësimit;
 - (iv) për mirëmbajtjen pas realizimit të objektit.
- 1.2 Ky projekt financohet nga Buxheti i Shtetit (Rigjenerimi Urban në zona periferike dhe informale dhe në fshatra me popullsi të dendur), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të FSHZH-së si dhe konfirmuar nga Ministria e Financave.
- 1.3 Projekti është aplikuar për financim nga Bashkia Dibër me shkresën nr. 2241 prot, datë 18.06.2025, protokolluar në FSHZH me nr. 2747 prot, datë 19.06.2025.
- 1.4 Fondi Shqiptar të Zhvillimit do të jetë agjencia e zbatimit të projektit.

Neni 2

Detyrimet e NjVV

NjVV duhet:

- 2.1 Të miratojë projektin për ndërhyrjen e propozuar, objekti i kësaj marrëveshje dhe të ketë realizuar konsultimin publik të dëgjësave me palët e interesit sipas parashikimeve ligjore të ligjit nr. 146/2014 datë 30.10.2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik".
- 2.2 Të realizojë Oponencën Teknike për projektin në rastet kur e parashikon ligji.
- 2.3 Të garantojë se nuk ka konflikt juridik dhe/ose social që lind nga pronësia mbi sheshin e ndërtimit ku do të zbatohet projekti.
- 2.4 Të marrë përsipër përgjegjësinë për zgjidhjen e problemeve juridike dhe/ose sociale që lindin nga pronësia mbi truallin dhe çdo lloj problemi tjetër të mundshëm që pengon zbatimin e punimeve.

- 2.5 Të realizojë, përpara fillimit të punimeve të ndërtimit, procesin e shpronësimit dhe të marrjes në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik, në përputhje me ligjin shqiptar.
- 2.6 Të marrë përsipër që në çdo konflikt të mundshëm gjyqësor që rrjedh nga zbatimimi i objektit të kësaj marrëveshjeje, NjVV-ja të futet në pozitën procedurale të të paditurit në vend të FSHZH-së, sipas nenit 184 të KPrC-së.
- 2.7 Të lëshojë Lejen e Ndërtimit me zhvillues "NJVV", duke sjellë përjashtimin e NJVV-së dhe FSHZH-së nga detyrimi për të paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë, në aplikim të nenit 46/3 të ligjit 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" ose NjVV-ja duhet të aplikojë pranë KKT-së për të nxjerrë lejen e ndërtimit.
- 2.8 Të respektojë Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe të respektojë kushtet e mbrojtjes së mjedisit në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 2.9 Të sigurojë Autorizimin ose Lejen Mjedisore duke mbuluar financiarisht tarifën përkatëse si dhe të sigurojë të gjitha lejet e tjera administrative kundrejt mbulimit financiar të kostove përkatëse, të cilat janë të nevojshme konform legjislacionit shqiptar.
- 2.10 Të dorëzojë sheshin e ndërtimit të projektit firmës zbatuese të punimeve brenda një afati prej 15 ditësh pas nënshkrimit të kontratës me firmën zbatuese të punimeve.
- 2.11 Të monitorojë zbatimin e projektit teknik, konform legjislacionit në fuqi.
- 2.12 Të marrë përsipër mirëmbajtjen dhe funksionimin e objektit pas marrjes përfundimtare në dorëzim të punimeve.
- 2.13 Të shkëmbejë informacion, në kuadër të kësaj marrëveshjeje, me FSHZH dhe mbikqyrësin e punimeve me qëllim mbarrëvajtjen e këtij investimi.
- 2.14 Të pranojë se në rast të mosrespektimit të këtyre rregullave dhe dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, FSHZH rezervon të drejtën të mos procedojë me nënshkrimin e kontratës së punimeve me O.E dhe NjVV do të përgjigjet për të gjitha kostot e shkaktuara FSHZH-së si dhe të humbasë të drejtën e përfitimit të një investimi të ri nga FSHZH, për një periudhë të përcaktuar nga FSHZH.

Neni 3 Detyrimet e FSHZH

FSHZH merr përsipër:

- 3.1 Të financojë punimet për zbatimin e projektit pas firmosjes së kësaj Marrëveshjeje, deri në masën e financimit të kontratës së nënshkruar midis FSHZH dhe Operatorit/operatorëve ekonomikë.
- 3.2 Të financojë kostot për mbikqyrësin dhe kolaudimin e punimeve, sipas kontratave përkatëse të nënshkruara me operatorët ekonomikë.
- 3.3 Të kryejë prokurimin e punimeve, shërbimeve të mbikqyrjes dhe kolaudimit në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3.4 Të ndjekë realizimin e projektit në përputhje me standardet teknike, mjedisore, sociale dhe financiare.

3.5 T'i dorëzojë NJVV së projektin e zbatuar sipas faktit pas përfundimit të periudhës së garancisë së defekteve.

Neni 4

Realizimi i punimeve

- 4.1 Projekti i përcaktuar në pikën 1.1 të nenit 1, konsiston në emërtimin: " Rigjenerimi Urban në zona periferike dhe informale dhe në fshatra me popullsi të dendur, etj Rajonet 1&2 - Rigjenerim urban i fshatit Lurë, Bashkia Dibër".
- 4.2 Këto punime do të realizohen në përputhje të plotë me projektin teknik të zbatimit.
- 4.3 FSHZH ka të drejtë të miratojë ndryshimet nga projekti fillestar i zbatimit vetëm pasi mbikqyrësi e kërkon zyrtarisht këtë ndryshim. Në të tilla raste mbikqyrësi paraqet dokumentacionin e plotë teknik i cili justifikon ndryshimet e propozuara.
- 4.4 Projekti do të zbatohet në përputhje me periudhën e përcaktuar në kushtet e Kontratës së Punimeve.
- 4.5 NJVV ka të drejtë të inspektojë punimet gjatë gjithë periudhës së realizimit të tyre. Çdo vërejtje objektive nga NJVV do të merret në konsideratë gjatë periudhës së zbatimit të projektit, deri në momentin e kolaudimit të tij. Pas kësaj periudhe vërejtjet quhen të ezauruara edhe nëqoftëse nuk janë bërë.

Neni 5

Dorëzimi i objektit

- 5.1 Pas njoftimit zyrtar nga mbikqyrësi për përfundimin e punimeve brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditë dorëzohet dosja teknike e objektit të zbatuar në dy kopje në FSHZH. FSHZH, një kopje të dosjes teknike të objektit të zbatuar, ia dërgon zyrtarisht NJVV-së.
- 5.2 FSHZH i vë në dispozicion Kolaudatorit dosjen teknike të objektit të zbatuar për të kryer kolaudimin e punimeve të këtij objekti që finalizohet me Aktin e Kolaudimit.
- 5.3 FSHZH cakton gjithashtu datën e inspektimit në terren dhe njofton zyrtarisht NJVV, Kontraktorin dhe Mbikqyrësin e Punimeve për të kryer inspektimin në objekt me qëllim Marrjen në Dorëzim të Përkohshëm të këtij objekti. Njoftimi bëhet minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike para kryerjes së Aktit të Kolaudimit dhe përton me datën e kolaudimit.
- 5.4 Në rastin kur NJVV-ja, në afatin e caktuar në pikën 5.3, për realizimin e inspektimit (kontrollit) në terren nuk merr pjesë në inspektim/kontroll dhe refuzon nënshkrimin e Certifikatës së Marrjes së Përkohshme në Dorëzim pa dhënë arsye objektive me shkrim, atëherë objekti do të quhet i marrë në dorëzim të përkohshëm nga NJVV-ja dhe ljo certifikatë do të konsiderohet e vlefshme.
- 5.5 Periudha e Garancisë së punimeve të objektit do të jetë sipas afatit të përcaktuar në kontratën e zbatimit të punimeve dhe do të fillojë nga data e kryerjes së Aktit të Kolaudimit.
- 5.6 NJVV ka të drejtë të njoftojë FSHZH për çdo problematikë apo defekt që mund të konstatojë gjatë gjithë periudhës së garancisë së punimeve.

- 5.7 ~~Minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara përfundimit të Periudhës së Garancisë së Punimeve, FSHZH njofton zyrtarisht NJVV, Kontraktorin, Kolaudatorin dhe Mbikqyrësin e Punimeve për të kryer inspektimin (kontrollin) në objekt me qëllim Marrjen në Dorëzim Përfundimtar të këtij objekti. Nëse konfirmohet se nuk ka defekte ose/dhe defektet janë riparuar, do të firmoset Certifikata e Marrjes Përfundimtare në Dorëzim të Punimeve, të cilës i bashkëlidhet i gjithë dokumentacioni tekniko ligjor i zbatimit të objektit.~~
- 5.8 Në rastin kur NJVV-ja, në afatin e caktuar në pikën 5.7, për realizimin e inspektimit (kontrollit) në terren nuk merr pjesë në inspektimin/kontrollin e përcaktuar dhe refuzon nënshkrimin e Certifikatës së Marrjes Përfundimtare në Dorëzim pa dhënë arsye objektive me shkrim, atëherë objekti do të quhet i marrë në dorëzim përfundimtar nga NJVV-ja dhe kjo certifikatë do të konsiderohet e vlefshme.
- 5.9 Me nënshkrimin e Certifikatës së Marrjes Përfundimtare në Dorëzim të cilës i bashkëlidhet i gjithë dokumentacioni tekniko ligjor i zbatimit të objektit, pavarësisht se NJVV-ja nuk mund të jetë e pranishme, objekti kalon zyrtarisht nën administrimin dhe inventarin e NJVV-së e cila ndjek dhe procedurat për pasqyrimin dhe regjistrimin e asetit (të objektit) të dorëzuar sipas kërkesave të ligjit shqiptar.

Neni 6

Zgjidhja e Marrëveshjes para përfundimit të afatit të saj

Në rast të pezullimit apo anulimit të fondeve nga Buxheti, me të cilat financohet ky projekt, do të pezullohen apo anulohen sipas rastit edhe financimi i këtij investimi nga FSHZH dhe kjo Marrëveshje do të zgjidhet pa penaltite.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 7.1 NJVV dhe FSHZH do të bëjnë çdo përpjekje për të zgjidhur miqësisht me negociata direkte në takime dhe biseda verbale çdo mosmarrëveshje ose konflikt që mund të kenë midis tyre për çfarë lidhet me këtë Marrëveshje.
- 7.2 Nëse pas tridhjetë ditësh nga fillimi i negociatave informale konflikti nuk zgjidhet, mund të angazhohet një palë e tretë e pavarur për ndërmjetësim (p.sh. Prefekti i Qarkut), për zgjidhjen e tij. Në rast se edhe pas këtyre negociatave, konflikti nuk zgjidhet, palët do t'i drejtohen Gjykatës e cila ka kompetencën territoriale dhe lëndore për zgjidhjen e tij.
- 7.3 Palët e kësaj Marrëveshje njohin dhe pranojnë që çdo gjykim do të bëhet duke u bazuar në kushtet dhe kërkesat e kësaj Marrëveshje.

Neni 8

Komunikimi

- 8.1 Komunikimi midis palëve do të jetë i vlefshëm vetëm kur bëhet me shkrim.
- 8.2 Një njoftim do të jetë i vlefshëm vetëm pasi të ketë mbërritur në destinacionin e tij.


Neni 9
Hyrja në fuqi

- 9.1 Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja palët.
- 9.2 Kjo marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe dhe përbëhet nga 3 (tri) kopje gjithsej, 2 (dy) kopje për FSHZH dhe 1 (një) kopje për NjVV.

Drejtori Ekzekutiv i FSHZH

Dritan AGONI


Emër, Mbiemër, Firmë, Vullë



Kryetari i Bashkisë Dibrë

Rahim SPAHIU

Emër, Mbiemër, Firmë, Vullë





FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT

REPUBLIKA E SHQIPERISE
FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

**OBJEKTI: "RIGJENERIM URBAN NË ZONA PERIFERIKE DHE INFORMALE DHE NË
FSHATRA ME POPULLSI TË DENDUR, RAJONET 1&2 – RIGJENERIM URBAN I
FSHATIT LURË." BASHKIA DIBER**

**PROJEKT ZBATIM
HARTA KADASTRALE
GJURMA E NDERHYRJES**



" A & E ENGINEERING " sh.p.k

Adresa: Rr. "Mujo Ulqinaku"

Mob: ++355 (0)69 2079981


Mob: ++355 (0)69 2079982

ENGINEERING

HARTA KADASTRALE - GJURMA E NDERHYRJES

LEGJENDA

- Gjurma e Nderhyrjes
- Parcela
- Ndertesa





FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT

REPUBLIKA E SHQIPERISE
FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

**OBJEKTI: “RIGJENERIM URBAN NË ZONA PERIFERIKE DHE INFORMALE DHE NË
FSHATRA ME POPULLSI TË DENDUR, RAJONET 1&2 – RIGJENERIM URBAN I
FSHATIT LURË.” BASHKIA DIBER**

**PLANIMETRIA E ORGANIZIMIT
TE PUNIMEVE**



" A & E ENGINEERING " sh.p.k


Adresa: Rr. "Mujo Ulqinaku"

Mob: ++355 (0)69 2079981

Mob: ++355 (0)69 2079982

ENGINEERING

PLAN VENDOSJA




LEGJENDA

1. Hyrja ne kantier
2. Materiale inerte
3. Pllaka, tuba dhe rakorderi etj.
4. Vend grumbullim mbeturinash
5. Makineri
6. Lende Drusore
7. Magazine per mjetet e punes
8. Zyra
9. W.C.
10. Roja


- OBJEKTE NE RESTAURIM
- RRETHIM I PERKOQSHEM PANELE LLAMARINE
- HAPESIRA E PARKIMIT

PLANI ORGANIZIMIT TE PUNIMEVE

HYRJA NE KANTIER



PORTE METALIKE





LEGJENDA

1. Hyrja ne kantier
2. Materiale inerte
3. Pllaka, tuba dhe rakorderi etj.
4. Vend grumbullim mbeturinash
5. Makineri
6. Lende Drusore
7. Magazine per mjetet e punes
8. Zyra
9. W.C.
10. Roja

- OBJEKTE NE RESTAURIM
- RRETHIM I PERKOHSHEM PANELE LLAMARINE
- GJURMA E PARKIMIT

DETAJE TE RRETHIMIT ME LLAMARINE



LEGJENDA

1. Hyrja ne kantier
 2. Materiale inerte
 3. Pllaka, tuba dhe rakorderi etj.
 4. Vend grumbullim mbeturinash
 5. Makineri
 6. Lende Drusore
 7. Magazine per mjetet e punes
 8. Zyra
 9. W.C.
 10. Roja
- OBJEKTE NE RESTAURIM
 - RRETHIM I PERKOHSEM PANELE LLAMARINE
 - GJURMA E PARKIMIT



REPUBLIKA E SHQIPERISE
FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

RELACION TEKNIK

**OBJEKTI: “RIGJENERIMI URBAN NE ZONA PERIFERIKE DHE
INFORMALE DHE NE FSHATRA ME POPULLSI TE DENDUR,
RAJONET 1&2 – RIGJENERIM URBAN I FSHATIT LURE.”
BASHKIA DIBER**

TIRANE 2025

TABELA PERMBLEDHESE

.....	1
1. HYRJE	3
2. VIZIONI I ZHVILLIMIT DHE STRATEGJIA PËR ZONËN – FSHATI LURË	3
1.1 VIZIONI	3
1.2 VIZIONI PËR RIGJENERIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E VLERAVE TË FSHATIT LURË	4
1.3 PARIMET THEMELORE.....	4
1.4 STRATEGJIA	5
1.5 MASAT MBROJTËSE.....	6
3. ANALIZA SWOT	7
4. LISTA E PROJEKTEVE QE DO TE ZHVILLOHEN.....	8
PROJEKTI 01: REHABILITIMI I FASADAVE DHE CATIVE TE SHTEPIVE NE QENDER TE FSHATIT, PERFSHIRE PERMIRESIMIN E HAPESIRAVE TE GJELBERTA RRETH TYRE.....	8
PROJEKTI 02: REHABILITIMI DHE RIKONSTRUKTIMI I QENDRES SE SHERBIMEVE, PERFSHIRE PERMIRESIMIN E HAPESIRES SE GJELBER RRETH SAJ.	8
PROJEKTI 03: KRIJIMI I NJE PARKIMI.....	8
NDERHYRJE PER PERMIRESIMIN E HAPESIRAVE TE GJELBERTA.....	35

1. HYRJE

Qëllimi i projektit konsiston ne propozimin e veprave ndërtimore me standarde të larta si për zhvillimin e infrastruktures mbitoakesore dhe ate nëntokësore, përmirësimin e mobilitetit, rikualifikimin e hapësirave publike, rrugëve, përmirësimin funksional dhe estetik të çative, etj., në përputhje me parashikimet e planit për zonat e mbrojtura, për të promovuar hapësira publike dhe fshatra estetikë dhe ftues, si dhe për të nxitur ndërveprimin social dhe frymën komunitare ne fshatin Zogaj dhe Lure.

Ky projekt synon:

- Përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve
- Rritjen e nivelit të kënaqësisë së banorëve
- Rikthimin e hapësirave publike në shërbim të komunitetit banues
- Rritjen e numrit të sipërmarrësve në zonat e ndërhyrjes
- Rritjen e vlerës së pronës në zonat e ndërhyrjes

2. VIZIONI I ZHVILLIMIT DHE STRATEGJIA PËR ZONËN – FSHATI LURË

1.1 VIZIONI

Fshati **Lurë**, shtrihet në një nga zonat më piktoreske të Shqipërisë së Veriut, në afërsi të **Parkut Kombëtar të Lurës**, i njohur për **liqenet akullnajore, pyjet e dendur dhe peizazhin e pasur malor**. Zona mbart një trashëgimi të vyer natyrore dhe kulturore, me potencial të jashtëzakonshëm për zhvillim të turizmit malor, ekoturizmit dhe turizmit të aventurës. Vizioni për rigjenerimin dhe zhvillimin e Lurës fokusohet në **aktivizimin e potencialeve natyrore, kulturore dhe sociale** të zonës, duke ruajtur autenticitetin e saj dhe duke krijuar kushte të reja për **turizëm të qëndrueshëm, zhvillim ekonomik lokal dhe përmirësim të cilësisë së jetesës** së komunitetit.

Elementët kryesorë të këtij vizioni përfshijnë:

- a) Zhvillimi i Lurës si një **destinacion turistik dhe rekreativ** i lidhur ngushtë me Parkun Kombëtar dhe rrjetin e liqeneve.
- b) Risetimi i qendrës së fshatit përmes krijimit të hapësirave funksionale për banorët.
- c) Përmirësimi i infrastrukturës së aksesit, me **rehabilitimin e rrugës 17.5 km drejt liqeneve të Lurës**, për të siguruar qasje të qëndrueshme dhe të sigurt për turistët.

- d) Krijimi i një **parkimi publik** në qendër, për menaxhimin e fluksit turistik dhe rritjen e funksionalitetit të hapësirave.
- e) **Unifikimi i fasadave dhe çatave** përgjatë rrugës kryesore, duke ruajtur karakterin tradicional të fshatit dhe duke përmirësuar imazhin arkitektonik të zonës.

Vizioni i përgjithshëm synon ta shndërrojë Lurën në një **qendër të turizmit malor të qëndrueshëm**, ku zhvillimi ekonomik dhe ruajtja e vlerave natyrore e kulturore ecin paralelisht.

1.2 VIZIONI PËR RIGJENERIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E VLERAVE TË FSHATIT LURË

Ky vizion mbështetet në pesë shtylla kryesore:

1. **Ruajtja dhe valorizimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore** të Parkut dhe fshatit.
2. **Përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe të aksesit** drejt liqeneve dhe brenda fshatit.
3. **Restaurimi dhe unifikimi estetik** i fasadave dhe çatave tradicionale.
4. **Krijimi i një destinacioni turistik tërheqës** për vizitorë vendas dhe të huaj, duke ofruar përvoja autentike dhe mjedis të mirëmbajtur.

1.3 PARIMET THEMELORE

Parimi i parë:

Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Lurës. Ndërhyrjet përfshijnë kujdes të veçantë për peizazhin e Parkut Kombëtar, pastrimin dhe menaxhimin e hapësirave natyrore, si dhe ruajtjen e arkitekturës tradicionale të banesave karakteristike.

Parimi i dytë:

Përmirësimi i **infrastrukturës së aksesit** dhe mobilitetit të qëndrueshëm. Rehabilitimi i **rrugës 17.5 km drejt liqeneve të Lurës** është ndërhyrja më e rëndësishme, pasi mundëson qarkullim të sigurt dhe zhvillim të ekoturizmit pa dëmtuar mjedisin.

Parimi i tretë:

Restaurimi dhe unifikimi i fasadave dhe çatave të banesave përgjatë rrugës kryesore, me materiale tradicionale (gur, dru, cati druri). Kjo ndërhyrje do të ruajë autenticitetin vizual dhe do ta bëjë qendrën e fshatit më tërheqëse për vizitorët.

Parimi i katërt:

Krijimi i **pikave të reja funksionale** në qendër të fshatit — rikonstrukcioni I qendres së shërbimeve.

1.4 STRATEGJIA

Strategjia e projektit “**Rigjenerimi urban dhe përmirësimi i vlerave të fshatit Lurë, Dibër**” bazohet në zhvillimin e qëndrueshëm të infrastrukturës, mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, si dhe fuqizimin ekonomik të komunitetit lokal.

Objektivat

- Të **përmirësohet infrastruktura rrugore dhe publike**, me fokus në rrugën drejt liqeneve dhe hapësirat qendrore të fshatit.
- Të **restaurohet dhe funksionalizohet godina qendrore**, si një nyje turistike dhe komunitare.
- Të **ruhet autenticiteti arkitektonik** përmes unifikimit të fasadave dhe çative tradicionale.
- Të **forcohet identiteti turistik i Lurës** si portë hyrëse drejt Parkut Kombëtar dhe liqeneve.

Qasja

Qasja strategjike ndërthur **zhvillimin fizik dhe ekonomik** me ruajtjen e mjedisit dhe trashëgimisë. Përdorimi i **materialeve lokale** dhe përfshirja e komunitetit janë thelbësore për qëndrueshmërinë e projektit.

Zhvillimi bazohet në modelin e **ekoturizmit gjithëvjeter**, që respekton mjedisin malor dhe ofron mundësi të reja punësimi.

Drejtimit Strategjike

- **Përmirësimi i aksesit dhe mobilitetit:** rehabilitimi i rrugës 17.5 km drejt liqeneve.
- **Rigjenerimi i qendrës së fshatit:** rikonstruksioni i godinës në qendër të fshatit.
- **Menaxhimi i fluksit turistik:** ndërtimi i një **parkimi publik** të përshtatur me mjedisin.
- **Unifikimi estetik i fasadave:** përmirësimi i pamjes së përgjithshme të fshatit.
- **Promovimi i Lurës si destinacion turistik natyror dhe kulturor.**

Ndërhyrjet kryesore

1. **Ndërtimi i parkimit publik** në qendër të fshatit.
2. **Rehabilitimi i rrugës 17.5 km** që lidh qendrën e fshatit me liqenet e Lurës.
3. **Rikonstruksioni i godinës ekzistuese** pranë njësisë administrative.
4. **Unifikimi i fasadave dhe çative** përgjatë rrugës kryesore, duke përdorur materiale tradicionale dhe ngjyra harmonike me mjedisin.
5. **Përmirësimi i disa hapësirave të gjelbërta në qendër të fshatit.**

1.5 MASAT MBROJTËSE

Masat mjedisore dhe sociale

Ndërhyrjet e propozuara janë përmirësuese dhe nuk pritet të kenë ndikim negativ në mjedis apo biodiversitetin e Parkut Kombëtar të Lurës.

Zbatimi i projektit do të shoqërohet me:

- **Kufizim të ndikimeve të përkohshme** gjatë punimeve (pluhur, zhurmë, qarkullim).
- **Menaxhim të mbetjeve ndërtimore** sipas standardeve mjedisore.
- **Sisteme të ujërave të bardha dhe të ndotura** që shmangin ndotjen e liqeneve dhe tokës.

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore

Zbatimi i projektit do të respektojë Ligjin nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” dhe aktet nënligjore për mbrojtjen e peizazheve natyrore dhe rurale.

Të gjitha ndërhyrjet në ndërtesat ekzistuese do të kryhen me **materiale autentike dhe teknika tradicionale** të përshtatura me klimën malore dhe karakterin lokal.

Masat sociale dhe përfshirja e komunitetit

- **Trajnime për banorët lokalë** në fushën e shërbimeve turistike, menaxhimit të bujtinave dhe shitjes së produkteve tradicionale.
- **Ndërgjegjësim për ruajtjen e mjedisit dhe peizazhit natyror.**
- **Përfshirje e bizneseve lokale** në menaxhimin e hapësirave të reja publike (parkimi, info-point, tregu).
- **Nxitja e ndjenjës së pronësisë** dhe bashkëpunimit për mirëmbajtjen e infrastrukturës së re.

Zbatimi i këtij projekti për fshatin **Lurë** pritet të sjellë përfitime të dukshme:

Përfituesit	Përfitimet
Banorët lokalë	Përmirësim i kushteve të jetesës, rritje e mundësive ekonomike, përfshirje në turizëm dhe tregti lokale.
Vizitorët dhe turistët	Akses i përmirësuar drejt liqeneve, shërbime turistike cilësore dhe përvojë autentike në një mjedis të pastër.
Bashkia Dibër	Zhvillim i qëndrueshëm i zonës, rritje e të ardhurave nga turizmi, forcim i identitetit kulturor dhe mjedisor të Lurës.

Ky projekt synon ta shndërrojë Lurën në një **model të rigjenerimit rural të qëndrueshëm në Shqipëri**, ku natyra, trashëgimia dhe zhvillimi ekonomik bashkohen në një ekuilibër të qëndrueshëm për brezat e ardhshëm.

3. ANALIZA SWOT



FORCAT (STRENGTHS)

- **Pasuri natyrore e jashtëzakonshme: prania e Parkut Kombëtar të Lurës, me liqenet akullnajore, pyje me pisha, bredha dhe bimësi të rrallë.**
- **Potencial i lartë për turizëm malor dhe natyror: mundësi për ecje, alpinizëm, kamping dhe eksplorim të liqeneve.**
- **Traditë kulturore dhe mikpritje tipike dibrane, që përbën vlerë për turizmin kulturor.**
- **Pozicion gjeografik strategjik midis zonave malore të Dibrës dhe rrugëve që lidhin drejt Kukësit apo Rrugës së Arbrit.**
- **Tokë pjellore dhe burime ujore të pastra, të përshtatshme për bujqësi dhe blegtori.**

DOBËSITË (WEAKNESSES)

- **Infrastrukturë e dobët rrugore dhe mungesë aksesibiliteti, veçanërisht gjatë dimrit për shkak të borës.**
- **Shërbime turistike të pakta: mungesë bujtinash të rregulluara, restorantesh tradicionale dhe guidash profesionale.**
- **Emigrim i lartë i popullsisë së re, që ka ulur aktivitetin ekonomik dhe social në fshat.**
- **Mungesë investimesh publike dhe private në ruajtjen dhe promovimin e parkut natyror.**
- **Probleme me menaxhimin e mbetjeve dhe ruajtjen e mjedisit në disa zona të parkut.**

MUNDËSITË (OPPORTUNITIES)

- **Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm dhe ekologjik, me fokus në natyrën e paprekur dhe biodiversitetin e pasur.**
- **Programe financimi nga BE dhe donatorë për zhvillimin e zonave të mbrojtura dhe ekonomisë rurale.**

- Krijimi i bujtinave tradicionale dhe promovimi i produkteve vendase (djathi, mjalti, bimët mjekësore, etj.).
- Rritja e interesit për turizmin natyror dhe aventuror në Shqipëri, që mund të sjellë vizitorë vendas e të huaj.
- Bashkëpunimi me bashkitë përreth dhe operatorët turistikë për të përfshirë Lurën në itineraret veriore të turizmit.

KËRCËNIMET (THREATS)

- Ndryshimet klimatike që ndikojnë në ekosistemin e liqeneve të Lurës dhe pyjeve alpine.
- Rreziku nga shfrytëzimi i paligjshëm i pyjeve apo ndërtimet pa leje brenda parkut kombëtar.
- Izolimi gjeografik mund të pengojë zhvillimin ekonomik në mungesë të investimeve në infrastrukturë.
- Konkurrenca me destinacione të tjera malore si Valbona, Thethi apo Rabdishti.
- Mungesa e edukimit mjedisor që mund të çojë në dëmtime të zonës për shkak të turizmit të pakontrolluar.

4. LISTA E PROJEKTEVE QE DO TE ZHVILLOHEN

PROJEKTI 01: REHABILITIMI I FASADAVE DHE CATIVE TE SHTEPIVE NE QENDER TE FSHATIT, PERFSHIRE PERMIRESIMIN E HAPESIRAVE TE GJELBERTA RRETH TYRE.

PROJEKTI 02: REHABILITIMI DHE RIKONSTRUKTIMI I QENDRES SE SHERBIMEVE, PERFSHIRE PERMIRESIMIN E HAPESIRES SE GJELBER RRETH SAJ.

PROJEKTI 03: KRIJIMI I NJE PARKIMI.

PLANSISTEMIMI




Ortofoto e qendres se Lures me projektet qe do te zhvillohen

PROJEKTI 01: REHABILITIMI I FASADAVE DHE CATIVE TE SHTEPIVE NE QENDER TE FSHATIT, PERFSHIRE PERMIRESIMIN E HAPESIRAVE TE GJELBERTA RRETH TYRE.

1.6 NDËRHYRJE PËR PERMIRESIMIN ESTETIK

Permiresimi Estetik dhe Funkcional i Cative dhe Fasadave te 6 ndertesave ne qender te fshatit



Tipologjia arkitektonike e banesave karakteristike të Lurës

Banesat tradicionale të fshatit Lurë përfaqësojnë një trashëgimi të çmuar të arkitekturës veriore, të ndikuar nga faktorët klimatikë, materiali vendas dhe mënyra e jetesës së komunitetit rural. Ndër elementet më karakteristike të këtyre shtëpive dallohen:

- **Muret e ndërtuara me gurë të vendit**, shpesh të lënë në dukje ose të suvatuar pjesërisht;
- **Dritaret me kanata druri**, të thjeshta, zakonisht të vogla dhe me funksion izolues;
- **Çatitë e pjerrëta me mbulose druri**;
- **Fasada të thjeshta**, pa zbukurime, me një trajtim funksional dhe të ndërtuar me qëllim mbrojtjeje ndaj kushteve të motit.


Gjendja aktuale dhe problematikat e hasura



Foto te ndertesave ne qender te fshatit

Ne foton e mesiperme tregohet gjendja ekzistuese e disa ndertesave ne qender te fshatit, ku evidentohet degradimi i natyrshëm i tyre në mungesë të ndërhyrjeve te mirembajtjes ndër vite. Problematikat e konstatuara përfshijnë:


- **Degradim i suvase**, si pasojë e lagështirës dhe mungeses se mirembajtjes;
- **Prania e lagështisë në pjesët e poshtme të murit**, që shkakton dëmtime strukturore dhe rrezik për ruajtjen e muraturës tradicionale;
- **Dritare jofunksionale**, të dëmtuara dhe të bllokuara, pa izolim dhe me dëmtime të strukturës së kornizës së drurit;
- **Çati e dëmtuar dhe e amortizuar**, që nuk ofron mbrojtje adekuate nga reshjet dhe e rrezikon të gjithë strukturën e banesës.



Gjendja ekzistuese e nje prej ndertesave ne qender te fshatit

Zgjidhja e propozuar dhe ndërhyrja për përmirësimin e fasadave dhe unifikimit të çative

Në funksion të ruajtjes së identitetit arkitektonik të zonës dhe përmirësimit të kushteve të banimit, është propozuar një **projekt restaurimi i fasadave dhe çative**, duke respektuar karakteristikat lokale dhe duke përdorur materiale që përshtaten me kontekstin rural dhe klimën e ftohtë të Lurës.




Referuar vizatimit ndërhyrjet:

- **Përmirësim të fasadës së jashtme duke hequr pjesën e suvase se degraduar dhe risubatimin e fasades** mbi muraturën ekzistuese, me qëllim mbrojtjen nga lagështia dhe ruajtjen e stabilitetit të strukturës;
- **Zëvendësimin e dritareve me dritare të reja me kanata druri**, të përshtatura me modelin tradicional, por me performancë më të mirë termoizoluese;
- **Pajisjen e dritareve me grila druri**, të cilat jo vetëm përmirësojnë aspektin estetik, por edhe mbrojnë ndërtesat nga kushtet klimatike, duke ruajtur stilin karakteristik të shtëpive

tradicionale. Ky ndërhyrje nuk synon vetëm përmirësimin fizik të godinave, por edhe **rivlerësimin e identitetit kulturor të Lurës**, duke e kthyer zonën në një model të integritit midis trashëgimisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm turistik. Përmes ruajtjes së materialeve, teknikave dhe formave tradicionale, projekti do të kontribuojë në krijimin e një atmosfere autentike që pasqyron historinë, kulturën dhe shpirtin e vendit.

- **Çatitë do të realizohen me konstruksion druri dhe mbulesë tradicionale druri**, në përputhje me karakterin arkitektonik të zonës malore të Lurës.
- **Vendosjen e veshjeve dekorative prej guri perreth dritareve, qosheve te mureve, dyerve dhe xokolatures**, duke respektuar elementet e trashëguar të ndërtimit lokal.


GJENDJA EKZISTUERE NDERTESA 1




REHABILITIMI




GJENDJA EKZISTUESE
NDERTESA 1




REHABILITIMI




GJENDJA EKZISTUESE
NDERTESA 1




REHABILITIMI




GJENDJA EKZISTUESE
NDERTESA 1



REHABILITIMI



**GJENDJA EKZISTUESE
NDERTESA 2**



REHABILITIMI



**GJENDJA EKZISTUESE
NDERTESA 2**



REHABILITIMI




**GJENDJA EKZISTUESE
NDERTESA 2**




REHABILITIMI




**GJENDJA EKZISTUESE
NDERTESA 2**



REHABILITIMI



GJENDJA EKZISTUESE
NDERTESA 2



REHABILITIMI




GJENDJA EKZISTUESE
NDERTESA 3



REHABILITIMI




**GJENDJA EKZISTUESE
NDERTESA 3**




REHABILITIMI




**GJENDJA EKZISTUESE
NDERTESA 3**



REHABILITIMI



**GJENDJA EKZISTUESE
NDERTESA 3**



REHABILITIMI




**GJENDJA EKZISTUESE
NDERTESA 4**



REHABILITIMI




GJENDJA EKZISTUESE
NDERTESA 4




REHABILITIMI




GJENDJA EKZISTUESE
NDERTESA 4



REHABILITIMI



**GJENDJA EKZISTUESE
NDERTESA 4**



REHABILITIMI




**GJENDJA EKZISTUESE
NDERTESA 5**



REHABILITIMI



GJENDJA EKZISTUESE
NDERTESA 5




±4.80


REHABILITIMI




GJENDJA EKZISTUESE
NDERTESA 5




REHABILITIMI




**GJENDJA EKZISTUESE
NDERTESA 5**



REHABILITIMI




**GJENDJA EKZISTUESE
NDERTESA 6**



REHABILITIMI




GJENDJA EKZISTUESE
NDERTESA 6




REHABILITIMI




GJENDJA EKZISTUESE
NDERTESA 6




REHABILITIMI



GJENDJA EKZISTUESE
NDERTESA 6



REHABILITIMI



RENDERA






**PROJEKTI 02: REHABILITIMI DHE RIKONSTRUKTIMI I QENDRES SE
SHERBIMEVE, PËRFSHIRE PERMIRESIMIN E HAPESIRES SE GJELBER
RRETH SAJ.**




Në kuadër të projektit për rigjenerimin dhe përmirësimin e qendrës së fshatit **Lurë**, ndërhyrjet e parashikuara në **godinën ekzistuese ku ndodhet njësisë administrative** janë ndërhyrje të brendshme, që synojnë krijimin e një **qendre shërbimesh**, që do të shërbejë si pikë orientimi, informimi dhe mikpritjeje për vizitorët, si dhe si hapësirë mbështetëse për komunitetin lokal. (Në këto ndërhyrje përfshihen dhe hapësirat dedikuara njesise administrative)



Propozimet për rehabilitimin e brendshëm të kësaj ndërtese janë konceptuar për të siguruar **funksionalitet, aksesueshmëri dhe estetikë bashkëkohore**, në harmoni me karakterin tradicional të arkitekturës së zonës. Kjo qendër do të përfshijë:

- Hapsiren kryesore ku do të kryhen shërbime të ndryshme
- Hapsiren ndihmëse



1-Administarata

Ndërrhyrjet në pjesën e administratës konsistojnë në një rikonstruktiv të plotë funksional të hapësirave ekzistuese, me qëllim përmirësimin e kushteve të punës dhe rikthimin e funksionit të plotë të godinës. Në këtë kuadër, parashikohet shtimi i tualeteve në të dyja katet e administratës, duke garantuar kushte më të përshtatshme higjieno-sanitare për stafin dhe përdoruesit.


Gjithashtu, do të realizohen ndarje të reja të brendshme, të konceptuara në mënyrë funksionale, të cilat do të optimizojnë organizimin e hapësirave dhe do të mundësojnë shfrytëzim më efikas të tyre. Këto ndërrhyrje synojnë të përmirësojnë qarkullimin, funksionalitetin dhe komoditetin e ambienteve administrative, duke i dhënë godinës një funksionim të plotë dhe bashkëkohor.

2. Qendra e Shërbimeve

Në pjesën e qendrës së shërbimeve parashikohet një rehabilitim dhe rikonceptim i plotë i brendshëm i ambienteve. Ndërrhyrja do të konsistojë në një rikonstruktiv total të hapësirave të brendshme, duke përshtatur strukturën dhe organizimin e tyre sipas nevojave funksionale të shërbimeve që do të ofrohen.

Si rezultat i këtyre ndërrhyrjeve, do të përfitohet një sallë shërbimesh me kushte koherente dhe të përshtatshme, e cila do të plotësojë standardet e nevojshme për funksionim normal, komoditet

dhe aksesueshmëri për përdoruesit. Qëllimi kryesor i këtij rehabilitimi është krijimi i një ambienti funksional, të rregullt dhe efikas për ofrimin e shërbimeve.




Rehabilitimi I godines 7

Në pjesën e qendrës së shërbimeve parashikohet një rehabilitim dhe rikonceptim i plotë i ambienteve të brendshme, me qëllim krijimin e një hapësire multifunkionale dhe bashkëkohore. Ndërhyrjet do të përfshijnë një rikonstruktim total të brendshëm, duke riorganizuar hapësirat në përputhje me nevojat funksionale dhe aktivitetet që do të zhvillohen në këtë ambient.


Salla kryesore do të ketë një veshje të veçantë me dru, e cila jo vetëm që i jep hapësirës një identitet estetik të ngrohtë dhe përfaqësues, por gjithashtu përmirëson ndjeshëm cilësinë akustike të ambientit. Të gjitha shkallët e sallës do të vishen me parket druri, duke garantuar vazhdimësi vizuale, komoditet dhe siguri për përdoruesit.

Falë këtij konceptimi dhe zgjedhjes së materialeve, salla do të mund të përdoret në mënyrë fleksibël si auditor për aktivitete institucionale, trajnime dhe takime, por edhe si teatër për shfaqje të ndryshme kulturore dhe artistike të zonës. Kjo ndërhyrje synon të krijojë një hapësirë funksionale, estetike dhe përfaqësuese, e cila do t'i shërbejë komunitetit dhe do të kontribuojë në zhvillimin e jetës kulturore dhe sociale të zonës.

PRERJA 1
GJENDJA EKZISTUESE



REHABILITIMI



PROJEKTI 03: KRIJIMI I NJE PARKIMI.



Konteksti dhe funksioni

Parkimi parashikohet të vendoset në afërsi të qendrës së fshatit Lurë. Qëllimi i tij është të:

- **Shërbejë si ndalesë** për vizitorët që vijnë me automjete,
- **Krijojë lehtësi ne akses.**

Vlerësimi i fluksit të automjeteve

Bazuar në të dhënat për **fluksin mesatar të vizitorëve në Lurë** dhe karakterin sezonal të turizmit:

- **Në periudha të zakonshme (pranverë–vjeshtë):** 10–15 automjete në ditë.
- **Në fundjavë dhe sezon veror (qershor–gusht):** 25–35 automjete / ditë, përfshirë 1–2 furgonë turistikë ose një autobus të vogël.
- **Banorët vendas:** 5–8 automjete ditore.


Përmasimi teknik i hapësirës së parkimit

Lloji i mjetit	Sipërfaqja mesatare / vend (me qasje & manovrim)	Nr. vendeve	Sipërfaqja totale
Vetura (makinë e vogël)	$5\text{ m} \times 2,5\text{ m} = 12,5\text{ m}^2$	25	$312,5\text{ m}^2$
Autobus / Furgon turistik	$12\text{ m} \times 4\text{ m} = 48\text{ m}^2$	2	96 m^2
Zona qarkullimi & mbrojtëse (rrugica, kthesa, gjelbërim)	—	—	~25–30 % shtesë = 120 m^2


◆ Totali i kërkuar minimal: $\approx 530\text{ m}^2$



Parkimi i Propozuar



Pamje Parkimit



Prerje Tip I Parkimit

NDERHYRJE PER PERMIRESIMIN E HAPESIRAVE TE GJELBERTA

Ky projekt synon përmirësimin dhe sistemimin e hapësirave të gjelbra në disa zona të caktuara të qendrës së fshatit Lurë, kryesisht përreth ndërtesave që do t'u nënshtrohen rehabilitimit të fasadave dhe unifikimit të cative. Ndërhyrjet do të përqendrohen në krijimin e mjediseve të gjelbëruara që do të përmiresojnë pamjen estetike të qendrës, duke ruajtur njëkohësisht karakterin tradicional dhe identitetin arkitektonik të zonës.

PLANSISTEMIMI




Ndërhyrjet për permiresimin e hapësirave të gjelberata

Hapësirat do të sistemohen me gjelbërim të ulët dhe të mesëm, duke përdorur bimësi vendase që i përshtatet klimës dhe terrenit malor të Lurës. Ndërmjet zonave të ndryshme do të vendosen garde druri të ulët, të cilat do të shërbejnë si ndarje dekorative, duke ruajtur një stil natyror dhe të përputhshëm me peisazhin lokal. Kalimet për këmbësorë do të realizohen me gurë të zonës, për të respektuar materialet dhe teknikat karakteristike të ndërtimit në këtë trevë.

Këto ndërhyrje do të përmirësojnë ndjeshëm cilësinë vizuale dhe funksionale të qendrës së fshatit, duke krijuar hapësira të rehatshme për pushim, shoqërim dhe zhvillim aktiviteteve komunitare. Përveç ndikimit estetik, hapësirat e gjelbra do të kontribuojnë në përmirësimin e mikroklimës lokale, në mbrojtjen e mjedisit dhe në rritjen e atraktivitetit të zonës për vizitorët dhe turistët që frekuentojnë Parkun Kombëtar të Lurës.

Në tërësi, projekti për përmirësimin e hapësirave të gjelbra përreth qendrës së fshatit përfaqëson një ndërhyrje të kujdesshme, e cila i jep rëndësi ruajtjes së identitetit tradicional, rrit vlerat mjedisore dhe nxit zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit lokal.

PLANRILEVIMI



LEGJENDE

- ▨ OBJEKTE BANIMI
- ▨ OBJEKTE KULTI


REPUBLICA E SHQIPERISE
FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

Projekt Zbatim
 2025

GRUPI I PROJEKTIMIT
 Ing. ENTELA CANO
 Ing. MEFAIL HALILAJ
 Ing. VALENTINA HOXHA
 Ark. PAQSOR KAJMAKU
 Ing. THANAS CARKA


GRUPI I PROJEKTIMIT
"A & E ENGINEERING" sh.p.k
 Adresa: Rr. "Mujo Ulqinaku"
 Mob: ++355 (0)69 2079981
 Mob: ++355 (0)69 2079982

OBJEKTI: "RIGJENERIM URBAN NË ZONA PERIFERIKE DHE INFORMALE DHE NË FSHATRA ME POPULLSI TË DENDUR, RAJONET 1 DHE 2 – RIGJENERIM URBAN I FSHATIT LURË." BASHKIA DIBER

SHKALLA
 1:500

Planrilevimi
 FL. 00



FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT

REPUBLIKA E SHQIPERISE
FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

**OBJEKTI: “RIGJENERIM URBAN NË ZONA PERIFERIKE DHE INFORMALE DHE NË
FSHATRA ME POPULLSI TË DENDUR, RAJONET 1&2 – RIGJENERIM URBAN I
FSHATIT LURË.” BASHKIA DIBER**

**PROJEKT ZBATIM
PLANVENDOSJA**



" A & E ENGINEERING " sh.p.k


Adresa: Rr. "Mujo Ulqinaku"

Mob: ++355 (0)69 2079981


Mob: ++355 (0)69 2079982

ENGINEERING



PLAN VENDOSJA



PLAN VENDOSJA



QENDER SHEBIMESH

 <p>REPUBLIKA E SHQIPERISE FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT</p>	Projekt Zbatim	GRUPI I PROJEKTIMIT		 <p>GRUPI I PROJEKTIMIT "A & E ENGINEERING" sh.p.k Adresa: Rr. "Mujo Ulqinaku" Mob: ++355 (0)69 2079981 Mob: ++355 (0)69 2079982</p>	OBJEKTI: "RIGJENERIM URBAN NË ZONA PERIFERIKE DHE INFORMALE DHE NË FSHATRA ME POPULLSI TË DENDUR, RAJONET 1 DHE 2 – RIGJENERIM URBAN I FSHATIT LURË." BASHKIA DIBER	SHKALLA
	2025	Ing. ENTELA CANO Ing. MEFAIL HALILAJ Ing. VALENTINA HOXHA	Ark. PAQSOR KAJMAKU Ing. THANAS CARKA		Planvendosja	FL. 00




FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT

REPUBLIKA E SHQIPERISE
FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

**OBJEKTI: "RIGJENERIM URBAN NË ZONA PERIFERIKE DHE INFORMALE DHE NË
FSHATRA ME POPULLSI TË DENDUR, RAJONET 1&2 – RIGJENERIM URBAN I
FSHATIT LURË." BASHKIA DIBER**

**PROJEKT ZBATIM
REHABILITIMI FASDAVE DHE CATIVE**



" A & E ENGINEERING " sh.p.k

Adresa: Rr. "Mujo Ulqinaku"

Mob: ++355 (0)69 2079981

Mob: ++355 (0)69 2079982

ENGINEERING

PLANSISTEMI




PLANSISTEMI



PLANSISTEMI

LUKURAVE TE ZELZA






SHTRIM ME GURE

GJELBERIM I ULET



GJELBERIM I LARTE

SISTEMIMI I HAPESIRAVE
TE GJELBERTA


DETAJE TE PLANSITEMIMIT



DETAJE TE PLANSITEMIMIT



DETAJI I STOLITTEPSHMIT MODELJ



MATERIALIZIM I STOLITTEPSHMIT MODELJ

